



Pranimi / Dorezimi Prilazje / Protokol Receipt / Delivery	25. 11. 2020	0	viti god year
Organ / Rreza Org / Dist	In Pret In Pret Prot No	Shifra Prot.ç Appendix	Sasia Kopjuna Quantity
SPANSHICK	2766/2020		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.296/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi – Bajraktari kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koci anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.296/2020, të datës 12.10.2020, së ankueses [REDACTED] me adresë banimi fsh Ndërkombëtar nr. 98, nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike „ transferim, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 24/11/2020, mori këtë:

V E N D I M

I. SHFUQIZOHET Vendimi i datës 18.09.2020, me numër protokoll Nr.Ref.161/2020, i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës..

II. DETYROHET Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të bëjë rishqyrtimin e rastit të ankueses duke u bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullonë këtë çështje.

III. OBLIGOHET Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED], me vendim me numër protokoll Nr.Ref.039/2020, të datës 10.02.2016, të Zëvendëskryeministri të parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, i është dhënë grada diplomatike “Këshilltare”, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë/ Itali.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 10.07.2020 ka nxjerr vendimin, me numër protokoll Nr.309/2020, me të cilin ankuesen [REDACTED] me gradën diplomatike

“Këshilltarë”, e cila ka shërbyer në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë/ Itali, pas përfundimit të mandatit, e kthen nga Misioni në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 18.09.2020, me numër protokoll 161/2020, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesen e ka sistemuar përkohshëm në pozitën “Zyrtare e lartë për Çështje Politike”, në Departamentin për Çështje Politike.

Ankuesja [REDAKTUAR], e pakënaqur me vendimin e datës 18.09.2020, me numër protokoll 161/2020 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për sistemim të përkohshëm, për mes e-mailit [ankesa.kpmshek@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshek@rks-gov.net), me datën 12.10.2020 me numër protokoll 2059/2020, me ankesë i është drejtuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 20.10.2020, me numër protokoll 2150/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datën 28.10.2020 me numër protokoll 2312/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A nr. 296/2020, e datës 12.10.2020, me numër protokoll 2059/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi i datës 30.05.2014; ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit; Vendimi i datës 18.09.2020; Vendimi i datës 10.02.2016; Vendimi i datës 10.07.2020; Përgjigjja në ankesë e datës 28.10.2020, me numër protokoll 2312/2020, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar lëndën e ankueses dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore që ankesa e ankueses të kthehet në *rishqyrtim* duke e obliguar zv.Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që rastin e ankueses [REDAKTUAR] ta trajtoj në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 18.09.2020, me numër protokoll Nr.Ref.161/2020, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesin e ka sistemuar përkohësisht në pozitën „Zyrtare e Lartë për Çështje Politike”, në Departamentin për Çështje Politike, këtë e ka bërë duke bazuar në nenin 4, pika 2.5, të ligjit Nr. 06/L-114,për Zyrtaret Publik, por në kundërshtim në me nenin 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1,1.2 Ligjit Nr.06/L-114,për Zyrtaret Publik, ku përcaktohet se: “1. *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtë kategori, në këto raste:1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve;1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve*”, prandaj Kolegji për shqyrtim e ankesave ka konstatuar se Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk e ka përcaktuar saktë se sa do të zgjasë transferimi i nëpunëses civile, [REDAKTUAR], por e ka sistemuar përkohshëm në pozitën “Zyrtare e Lartë për Çështje Politike”, e qe është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 18.09.2020, me numër protokoll 161/2020, vendimin e ka nxjerr edhe në kundërshtim me nenin 47, paragrafi 1.1,1.2,1.3,1.4 ,të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kundërshtim me nenin 48, paragrafi 2 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “2. *Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij*”. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi i datës

18.09.2020, me numër protokoli Nr.Ref.161/2020, i Zv. të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë i cili përcakton se: **“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit”**, po ashtu paragrafi 4 i nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë përcakton se : **“Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit.”** kështu që duke marr parasysh dispozitat ligjore të lartcekura Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është i obliguar të rishqyrtoj rastin e sistemimit të ankueses dhe të njëjtin ta bëjë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitave të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.296/2020**

**Rushit Kajtazi**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI - BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses [REDACTED]
- Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.